

AEC

AUDITUES ENERGJETIK I ÇERTIFIKUAR

Rregjistrimet kanë filluar!

Kursi hapet më: ✓

5 prill 2019

NË
BASHKËPUNIM
ME
ENEA

www.enea.it/en

Program i hartuar në bashkëpunim dhe me pjesëmarrjen e ekspertëve të Agjencisë Italiane për Teknologjitë e Reja, Energjinë dhe Zhvillimin Ekonomik të Qendrushëm (ENEA)

Programi i Audituesit Energjetik të Çertifikuar (AEC) rrit standardet e performancës në auditimin e energjisë në ndërtesa dhe industri dhe përmirëson praktikën e audituesve të energjisë nëpërmjet aplikimit të metodologjive kombëtare dhe ndërkombëtare të llogaritjes së performancës energjetike dhe pajisjeve inovative.

AEC është një program trajnimi **3 mujor**, për profesionistët që duan të aftësohen në shërbimet e auditimit të energjisë në ndërtesa dhe industri. Ky program është hartuar mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, mbi praktikën dhe metodologjinë e Agjencisë Italiane për Teknologjitë e Reja, Energjinë dhe Zhvillimin Ekonomik të Qendrushëm (ENEA). Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit që vlerësohen pozitivisht, pajisen me çertifikatën e Audituesit të Energjisë.

REZULTATET E KURSIT

Pas trajnimit AEC, pjesëmarrësit janë të aftë të punësohen në profilin e audituesit të energjisë, në sektorin e ndërtesave dhe industrisë, bazuar në standardet e praktikave më të mira dhe normativat ndërkombëtare. Figura e Audituesit të Energjisë është e përcaktuar në nenin 17 të ligjit nr. 124/2015 "PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË" dhe kryen çertifikimin e performancës së energjisë sipas nenit 12 të ligjit nr. 116/2016 "PËR PERFORMANCËN E ENERGJISË SË NDËRTESAVE".

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT

- Legjislacioni mbi efiçencën e energjisë;
- Burimet kryesore të energjisë;
- Bazat e Auditimit të energjisë mbështetur në protokollin ndërkombëtar të matjes dhe verifikimit IPMVP;
- Performanca energjetike në ndërtesa;
- Analizë dhe vlerësim tekniko-ekonomik i investimit për kursimin e energjisë;
- Teknologjitë dhe impiantet termike. Sistemet HVAC dhe performanca energjetike në sistemet elektrike;
- Konceptet bazë të analizës së një projekti të energjiave të pastra. *Software Retscreen International*;
- Laborator/Praktikë profesionale.

PROFILI I KËRKUAR

- Individë me eksperiencë në auditimin dhe menaxhimin e energjisë që e kanë të nevojshëm kualifikimin si auditues energjetik për të aplikuar për liçencë profesionale pranë Agjencisë për Efiçencën e Energjisë;
- Arkitektë, inxhinierë të ndërtimit, të mjedisit, elektrik, mekanik etj. të cilët kërkojnë të kualifikohen në auditim energjetik;
- Specialistë të ndërtesave të gjelbra, të njohur në nivel ndërkombëtar;
- Individë që janë në kërkim të mënyrave të ruajtjes së energjisë dhe burimeve në ndërtesa dhe industri.

AFTËSITË BAZË TË NEVOJSHME

Për t'u regjistruar në programin e trajnimit AEC duhet të zotërohen aftësi bazë si:

- bazat e algjebres;
- bazat e llogaritjes financiare

TESTI PËRFUNDIMTAR

Testimi përfundimtar do të zhvillohet 7 ditë kalendarike pas përfundimit të programit të trajnimit.

Regjistrimi i pjesëmarrësve do të kryhet nga 3-15 ditë kalendarike përpara datës së parashikuar të testimit.

KRITERET PËR T'U ÇERTIFIKUAR

Kriteret e vendosura për përzgjedhjen e aplikantëve bazohen në arsimimin dhe eksperiencat specifike të kandidatëve. Çdo kandidat për AEC, për të ndjekur programin e trajnimit duhet të ketë përfunduar një master profesional ose shkencor në profilet e mëposhtme:

- Arkitekt;
- Inxhinier ndërtimi;
- Inxhinier hidroteknik;
- Inxhinier mekanik;
- Inxhinier elektrik;
- Inxhinier topograf;
- Inxhinier mjedisi;
- Inxhinier i gjeoshkencave, energjisë, ujit dhe mjedisit.

HAPAT PËR T'U ÇERTIFIKUAR

1. Kursanti të frekuentojë 75 % të kursit të trajnimit;
2. Kursanti t'i nënshtrohet testimit përfundimtar me shkrim dhe të vlerësohet me notë kaluese më të lartë se 50 %;
3. Të plotësojë aplikimin për çertifikatën AEC;
4. Nëse kursanti nuk kualifikohet në testimin e parë, mund të përsërisë testimin në sezonin tjetër.

MUNDËSI PUNËSIMI

- Administrata publike, qendrore apo vendore;
- Sipërmarrje dhe kompani biznesi;
- Institucione publike që hartojnë dhe zbatojnë projekte të energjisë;
- Sektorë të ekonomisë;
- Sektorë të energjisë;
- Instituti i Monumenteve të Kulturës;
- Studio projektimi;
- Kompani ndërtimi;
- Sektorë të tjerë privat.

ÇERTIFIKIMI

Programi i trajnimit në Auditues Energjetik është i njohur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe ju pajis me një çertifikatë trajnimi profesional. Marrja e kësaj çertifikate ju mundëson të aplikoni për liçencën* e Audituesit Energjetik, pranë Agjencisë për Efiçencën e Energjisë (AEE).

**Nëse kursantët tanë nuk kalojnë me sukses testimin e liçencimit (brenda afatit 1 vjeçar nga përfundimi i trajnimit) "Universiteti Marin Barleti" ju ofron përsëritjen e programit të trajnimit, pa pagesë.*

KOSTO



Kosto totale e kursit: 100 000 lek



Kosto e aplikimit: falas



Kosto e provimit dhe Çertifikatës: falas



Kosto e përsëritjes së Provimit: 1 000 lek



Kosto e kursit përfshin: 3 muaj kurs trajnimi që do të zhvillohen 4 orë ditën e premte dhe 8 orë ditën e shtunë.

Kosto e provimit dhe çertifikimit përfshin: provim me kohëzgjatje 4 orë, kartonin e çertifikatës dhe ceremoninë e ndarjes së çertifikatave.

REGJISTRIMI

Vizitoni faqen e SHLUIJ "Universiteti Marin Barleti" në adresën <http://www.umb.edu.al/> ku mund të shkarkoni formatin e aplikimit. Pasi ta plotësoni, dërgojeni me email në:

✉ tvvet@umb.edu.al | a.carcani@bird.al

Për informacion kontaktoni në nr:

☎ +355 69 70 45 318

ORARET E TRAJNIMIT

Kursi do të zhvillohet në dy ditë:
e premte, ora 16.00- 20.00
e shtunë, ora 8.00- 16.00

STAFI I KUALIFIKUAR **AEC** AUDITUES ENERGETIK I ÇERTIFIKUAR

Ing. Patrizia Aversa (ENEA)
Ing. Leonardo Fallucchi (ENEA)
Prof. Dr. Pëllumb Berberi
Prof. Dr. Spiro Thodhorjani
Prof. As. Dr. Valbona Muda

Dr. Driada Mitrushu
Dr. Silvana Sukaj
Dr. Urim Buzra
Dr. Irma Bërdufi
Dr. Eduart Serdari
Dr. Daniela Halili



Adresa: **Kampusi 1**, Rruga e Kosovareve, Nd.37, H.1 Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri, (pranë digës së Liqenit Artificial)
Kampusi 2, Rruga Frang Bardhi, Nd. 118, Kodi postar 1022, Selitë, Tiranë | Cel: +355 69 20 62 086 | +355 69 20 41 222 | +355 69 20 67 247
E-mail: info@umb.edu.al | mastersecretary@umb.edu.al | admissions@umb.edu.al

Web: www.umb.edu.al

